

19.04.2021

Ora 17:47

RENDI I DITËS


Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesit të punës të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupit të Numërimit të Votave për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Meta**
- **Parti Politike: LSI, PD, PDIU**
- **Vëzhgues: OSBE/ODIHR**

Znj. I.Nano: Mirëmbërëma, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 17:30. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme është shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit të punës të komisionit të zonës së administrimit zgjedhor dhe grupit të numërimit të votave për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Prania e anëtarëve të Komisionit Rregullator është e plotë. Të pranishëm në mbledhje gjithashtu janë Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të Administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përfaqësues të subjekteve zgjedhore të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

akredituara në KQZ dhe përfaqësues të misionit të OSBE/ODIHR-it, gjithashtu akredituar në KQZ. Para se të fillojmë me shqyrtimin e aktit që kemi në rendin e ditës sipas rregullores po pyes ndërkohë kolegët dhe pjesëmarrësit nëse kanë diçka jashtë rendit të ditës. Po zoti Çakaj.

Z. M.Çakaj: Po. Si do ta vendosim, sepse unë kam disa çështje jashtë rendit të ditës?

Znj. I.Nano: Po, patjetër.

Z. M.Çakaj: Edhe në rendin e ditës edhe jashtë rendit të ditës. Kam disa çështje.

Znj. I.Nano: Dakord, së pari jashtë rendit të ditës ju keni rradhën i pari për të diskutuar. Kolegë të tjerë? Po zonja Vukaj.

Znj. H.Vukaj: Kam edhe unë diçka jashtë rendit të ditës. Kështu që meqenëse kolegu është i pari po vijoj pas tij.

Znj. I.Nano: Dakord, zoti Çakaj, zonja Vukaj. Zoti Çaka?

Z. D.Çaka: Po zonja Kryetare kam dhe unë diçka jashtë rendit të ditës për të diskutuar.

Znj. I.Nano: Zoti Çaka. Atëherë rradha.. zoti Çela ju kishit jashtë rendit të ditës? Po.

Z. A.Çela: Jo, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I.Nano: Faleminderit.

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nëse mundemi edhe unë kisha diçka për të diskutuar.

Znj. I.Nano: Po zoti Kaziaj. Nëse kolegët bien dakord për çështjet jashtë rendit të ditës gjithmonë. Meqenëse kemi tre anëtarë të Rregullatorit dhe një përfaqësues të subjektit zgjedhor t'ia japim fjalën së pari përfaqësuesit të subjektit zgjedhor dhe më pas kolegëve. Nuk e di a jeni dakord për rradhën?

Z. M.Çakaj: Dakord.

Znj. I.Nano: Dakord. Atëherë, kur të diskutojmë çështjet jashtë rendit të ditës rradha është zoti Kaziaj, zoti Çakaj, zonja Vukaj, zoti Çaka. Fillojmë atëherë me shqyrtimin e projektaktit që lexuam. Komisioni Rregullator në fakt ka miratuar dhe vendime të tjera lidhur me grupet e numërimit të votave, kriteret e caktimit të numrit të grupeve të numërimit të votave, organizimin e punës në vendin e numërimit të votave dhe në këtë moment vjen për shqyrtim projektakti i paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve lidhur me miratimin e udhëzuesit të komisionit të zonave të administrimit zgjedhor dhe grupit të numërimit të votave. Atëherë, nga administrata besoj është Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së që do të prezantoj projektaktin dhe relacionin. Po zoti Merkaj.


Z. Y.Merkaj: Atëherë, referuar nenit 20, paragrafi 1, shkronja “gj” e Kodit Zgjedhor Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton udhëzuesit (*nuk dëgjohet*) në shërbim të Administratës Zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

zgjedhësve. Udhëzuesi i punës së komisionit të zonës së administrimit zgjedhor dhe grupeve të numërimit të votave së bashku me Kodin Zgjedhor dhe akte të tjera nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe materialet informuese dhe edukuese do të përdoren në kurset e trajnimit të trajnierëve të KZAZ-ve dhe të anëtarëve të grupeve të numërimit. Udhëzuesi qartëson detyrat e KZAZ-së dhe të grupeve të numërimit të votave nga momenti i dorëzimit të kutive me fletët e votimit në kohë në KZAZ deri në tambulimin e rezultateve të zgjedhjeve për zonën zgjedhore. Ajo që mund t'i vijë në ndihmë anëtarëve të KZAZ-së dhe GNV-ve për veprimtarinë e tyre në administrimin e procesit zgjedhor, vlerësimin, numërimin dhe tambulimin e rezultateve të zgjedhjeve. Kur njohja, kuptimi dhe përvetësimi i procedurave të parashikuara në këtë udhëzues do të ndikojë në ngritjen e nivelit profesional të administratës dhe administrues të anëtarëve të KZAZ-ve dhe GNV-ve. Zgjedhjen me profesionalizëm (*nuk dëgjohet*) efektivitet nga ana e Administratës Zgjedhore të të gjitha problematikave të krijuara gjatë ushtrimit të detyrës. Në administrimin e procesit zgjedhor dhe zbatimet ligjore të detyrave të tyre funksionale në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Udhëzuesi i KZAZ-ve dhe i grupeve të numërimit përbëhet nga 6 krerë të strukturuar në ndarje si më poshtë:

KREU I përshkruan detyrat e anëtarëve të grupeve të numërimit, organizimin dhe teknologjin mbështetëse të KQZ-së në çdo vend të numërimit të votave dhe materialet, dokumentacionet bazë të grupit të numërimit të votave. Të drejtat e vëzhguesve dhe emërimi i tyre.

KREU II paraqet në mënyrë të detajuar rregullat për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore. Organizimin dhe detyrimin e grupit të marrjes në



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

dorëzim të tyre. Marrjen në dorëzim të kutive me materialet me fletët e votimit dhe konstatimin e kutive të parregullta dhe sistemin e tyre.

KREU III (*nuk dëgjohet*) që kryen me fillim e numërimit. Rradhën e numërimit. Vlerësimin e votave. Kontenstimin dhe rivlerësimin e tyre.

KREU IV përshkruan veprimet që kryen nga KZAZ-ja dhe grupi i numërimit për plotësimin e tabelës së rezultateve paraprake. Hedhjen e transmetimit elektronik të të dhënave. Nxjerrjen e tabelës së transmetimit elektronik dhe nxjerrjen e tabelës përmbledhjese.

KREU V informacion për përgjegjësitë dhe sanksionet. Rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor. Rastet e përgjegjësisë administrative dhe penale.

KREU VI jep informacion për procedurën e dërgimit të materialit zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Modelet e procesverbaleve KZAZ 25, 26 dhe 27. Ky manual synon të ndikojë në rritjen e cilësisë së trajnimit dhe kryerjen e detyrave me standardet më të larta nga anëtarët e grupeve të numërimit dhe komisioneve të zonës së administrimit zgjedhor. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si edhe udhëzuesin e punës për KZAZ-të dhe GNV-të, faleminderit.

Znj. I.Nano: Faleminderit zoti Merkaj. Çelim diskutimin në parim lidhur me projektaktin. Të nderuar kolegë, të nderuar përfaqësues të subjekteve zgjedhore. Po zoti Çakaj.

Z. M.Çakaj: Faleminderit e Nderuar. Fillimisht unë kam një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në orën 17:02 në email zyrtar na është risjell akti, manuali KZAZ-së dhe GNV-së i ripunuar. Ajo çfarë dua të di është a është ky akti i risjell i njëjtë me aktin që ju keni

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

paraqitur në ditën e Shtunë në momentin që keni kërkuar të thirret zyrtarisht mbledhja e Komisionit Rregullator apo ka ndryshime?

Z. Y.Merkaj: Po i njëjti është vetëm ka disa rregullime teknike shumë të vogla që nuk ndikojnë në përmbajtjen e aktit.

Z. M.Çakaj: A mund t'i kemi ato rregullimet teknike? Ndërhyrjet konkrete ku janë?

Z. Y.Merkaj: Për momentin..

Znj. I.Nano: Në fakt zoti Merkaj edhe unë të njëjtën pyetje kisha sepse vura re që tek titulli dhe më duket më korrekt në raport me.. pra ku konsistojnë ndërhyrjet?

Z. Y.Merkaj: Që nga titulli ishte “Manual” sepse rëndom është përdorë “manual” në të gjithë eksperiencën e KQZ-së. Është shkruar “Manuali i KZAZ-ve dhe i GNV-ve”. Së fundmi e kemi ndryshuar e kemi vënë “udhëzues” dhe e ndryshuam. E bëmë nga “Manual” në “Udhëzuesi i punës për KZAZ-të dhe GNV-të”. Kështu që nuk besoj se ky është një ndryshim thelbësor.

Z. M.Çakaj: Të tjera ndryshime ka?

Z. Y.Merkaj: Kemi vendosur në fund, fletët e votimit të pavlefshme (*nuk kuptohet*) vlerësimin dhe i kemi bashkëlidhur. Sepse tek materiali i parë nuk ka qenë. Kemi disa pasaktësi diku tek një.. që kemi vendosur një udhëzim të 2015-

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

ës që e hoqëm sepse nuk ka kuptim të ishim referuar tek ai udhëzim. Këto ishin ndryshimet.

Z. M.Çakaj: Pra, kanë qenë referenca ligjore gabim?

Z. Y.Merkaj: Po këto ishin. Nuk ka patur..

Z. M.Çakaj: Të tjera ndërhyrje nuk ka?


Z. Y.Merkaj: Ndryshime të tjera nuk ka.

Z. M.Çakaj: Dakord. Atëherë, së pari unë do të kërkoja nga kolegët mirëkuptimin që për korrektësi dhe për unifikim standardi t'i referohemi aktit që na është dërguar. Mbi të cilin kemi punuar individualisht gjithësecili. Akti që na është dërguar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ditën e Shtunë dhe nëse do të duhen ndryshime, saktësime, korrektesa atëherë t'i miratojmë të gjitha. Sepse në gjykimin tim këto janë ndryshime të cilat do të duhet t'i miratojmë ne. Kështu që besoj biem dakord për këtë pikë. Së pari kjo, gjatë momentit të shqyrtimit të aktit. Së dyti kemi dhe çështje të ndryshme, propozime konkrete të cilat besoj do t'i bëjmë gjatë shqyrtimit të aktit. Kur të vijë momenti, faleminderit.

Znj. I.Nano: Zonja Vukaj.

Znj. H.Vukaj: Duke qenë se nuk kemi kohën e mjaftueshëme për t'i dhënë besueshmëri maksimale sepse duhet parë përmbajtja. Duhet bërë krahasimi etj..

*Zbardhje materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

propozoj të njëjtën gjë të ecim dhe të vijojmë me aktin që ka sjellë zyrtarisht zoti Markaj të Shtunën në mbrëmje.

Znj. I.Nano: Në kuandër të këtij propozimi, unë do të propozoja shtyrjen e mbledhjes. Gjithsecili nga ne të marrë kohën për të parë ndryshimet. Në kushtet kur jemi një muaj para.. në periudhën një muaj para ditës së zgjedhjeve mbledhja mund të shtyhet jo më shumë se..


Z. Y.Merkaj: Një javë para.

Znj. I.Nano: Jemi një javë para zgjedhjeve. Por, në kuptim të rregullores tonë jemi në periudhën jo më shumë se një muaj nga data e zgjedhjeve. Periudhë në të cilën shtyrja e mbledhjes së Komisionit Rregullator mund të shkoj deri në 12 orë që do të thotë në maksimumin e saj do të zhvillohej nesër në mëngjes në orën 6 të mëngjesit. Por, nëse kolegët vlerësojnë që të marrim një orë, dy orë kohë dhe..

Z. M.Çakaj: E Nderuar në fakt me sa propozime deklaroi Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve? Sepse kishte. Unë nuk mendoj se nuk do të na duhen më shumë se 5 minuta për të saktësuar dhe nuk është çështje periudhe, kohë që do të shtymë mbledhjen por është çështje standardi. Kështu që të gjithë ne mesa kuptova edhe ju keni punuar mbi të njëjtin material që është nisur ditën e Shtunë apo jo? Sepse kjo vetëm në orën 17:00..

Znj. I.Nano: Jo, kur thashë për kohën edhe unë këtë standard.. në kuptim e standardit e referova kohën dhe orën.

*Zbardhj materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Z. M.Çakaj: Po pra, por nuk besoj do të na duhen më shumë se 5 minuta apo 10 minuta për të saktësuar këtë gjë. E shtymë, thërrasim edhe Sekretarin e Pergjithshëm..

Znj. I.Nano: Nëse lemë një orë.. 10 minuta kam frikë se është pak duke patur parasysh që do të shohim materialin. Do të shohim 2 variantet.

Z. M.Çakaj: Për 3 ndryshime?

Znj. H.Vukaj: Edhe pse ato janë vetëm aq ndryshime. Në titull hiq udhëzim.. dhe..

Znj. I.Nano: Zoti Metaj si drejtor i drejtorisë përkatëse mund të na thoni..

Znj. H.Vukaj: Mund të mbaroj fjalën të lutem?

Znj. I.Nano: Po, ndjesë zonja Vukaj.

Znj. H.Vukaj: Atëherë, i bie që boll të na e relatojë tani konkretisht ku janë ndryshimet dhe në qoftëse e gjejmë me vend ndryshimet janë të asaj shkalle dhe natyre që nuk diktojnë përmbajtjen dhe prishin regjimin aktit atëherë mund të vazhdojmë dhe i mbarojmë këtu pa e shtyrë mbledhjen, meqenëse jemi në kushtet e një date zgjedhje që na ndan me pak ditë.

Znj. I.Nano: Pikërisht një minutë më parë, unë këtë kërkova nga zoti Metaj që është Drejtor i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore dhe që është përgjegjësi le

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

të themi kryesore dhe pse akti vjen në emër të Komisionerit sigurisht që është konsultuar me Komisionerin para se të vi ndryshimi. Nëse mund të referoj në mënyrë më konkrete ku konsistojnë ndryshimet duke nisur nga titulli deri tek.. Është e mundur ta bëjë tani apo shtymë një orë mbledhjen?

Z. Y.Merkaj: (nuk kuptohet) dhe të flasim dhe për 5 minuta, 10 minuta jemi gati.

Znj. I.Nano: 10 minuta e ndërpresim seancën, atëherë mbledhjen.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021
Rifillon mbledhja*

Ora 18:23

Znj. I.Nano: Të nderuar kolegë, e ndërpreme mbledhjen, thamë për 10 minuta, në mënyrë që zoti Meta, drejtori i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore të na shpjegojë ku konsistojnë këto ndërhyrje që sekretari i Përgjithshëm tha, janë të karakterit teknik. Mundeni, ju lutem zoti Meta dhe pastaj është Rregullatori që do të vlerësojë vijimin?

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ne kishim një ndërhyrje në qoftë se na lejohet, para se t'i jepet fjala administratës, se dhe ne jemi të përfshirë në këtë proces, kemi interesin tonë si subjekt politik. Ky është një akt që është tagër i Rregullatorit dhe Rregullatori e çmon këtë akt, por gjithsesi qendrimi jonë është ky, që akti i sjellë deri para orës 17, të ditës së sotme, është një akt i konsultuar dhe Rregullatori ka të gjithë, të themi, në qoftë se ka atë pjesën e marrjes në shqyrtim të atij akti, që është sjellë në një kohë, dhe lënë për një kohë të mjaftueshme subjekteve politike që është konsultuar. Në qoftë se nga administrata e KQZ-së është bërë rregullim i pjesshëm, ndryshim, a mendim, Rregullatori nen për nen mund të ndryshojë ato nene që mendon të ndryshojë. Tani, sjellja e një akti në një procedurë, domethënë, kaq të shkurtër kohore, na bën që ne si parti politike të mos të mbrojmë dot interesat tona në qoftë se ka ndryshime të theksuara të këtij akti. Kështu që, Rregullatorit me shumë mirësjellje i propozoj që të vazhdojë me aktin e vjetër, dhe në qoftë se në votimin nen për nen, ose miratimin nen për nen të tij ka ndryshime, le ta vendosë aty ndryshimin.

Znj. I.Nano: Zoti Kaziaj, ju si subjekt zgjedhor keni paraqitur propozime me shkrim, meqenëse akti pararendës, po themi varianti i parë, ka ardhur në kohë?

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo, e nderuar! Kjo nuk do të thotë që...

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I.Nano: Faleminderit! Jo, jo, patjetër, jeni të pranishëm në seancë, unë thashë, nëse paraprakisht kishit. Zoti Nuraj?

Z. L.Nuraj, përfaqësues i PD-së: Atëherë, për ekonomi kohe kjo do të ishte më e arsyetueshme, që të vazhdojë Komisioni Rregullator nen për nen dhe atje ku të ishin ndryshimet të propozoheshin dhe pastaj të votoheshin, pasi dhe akti i ardhur në orën 5 pa 10, me e-mail, nuk është akti i fundit, nuk është se na është bërë me dije apo ndonjë relacion bashkëlidhur që të thoshte ka ndryshime apo nuk ka ndryshime nga akti i ardhur më përpara, kështu që duke parë që dhe mbledhja po hyn në një konfuzion.

Znj. I.Nano: Jo, nuk është fare në konfuzion mbledhja!

Z. L.Nuraj, përfaqësues i PD-së: Më mirë të japim një zgjidhje sa më ekonomike ose të shikojmë ku janë ndryshimet.

Znj. I.Nano: Ndërpreme mbledhjen, që zoti Meta të na paraqiste, ku i ka ndërhyrjet, sigurisht është tagër i Komisionit Rregullator miratimi i çdo gërme në këtë vendim dhe pastaj në tërësi, dhe Komisioni Rregullator në rastin konkret është vënë në lëvizje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe unë po e pyes edhe njëherë zyrtarisht sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Cili është akti i propozuar nga Komisioneri për t'u shqyrtuar në mbledhjen që kemi nisur Zoti Merkaj? Pastaj zoti Meta?

Z. Y.Merkaj: Atëherë zonja kryetare, kërkoj mirëkuptimin tuaj, jemi shumë të lodhur, jemi shumë të ngarkuar. Ky akt që u nis dje, është bërë nga shefja e trajnimeve, dhe unë pasi e nisa, e ripashë, dhe kishte gabime. Ishte gabim për shembull, një datë që kapa, shpejt e shpejt, 25 prill 2021 zhvillohen zgjedhjet për Kuvend të Republikës së Shqipërisë dhe mendova ta shikoja edhe njëherë, e bëra

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

nga 25 mars, 25 prill, dhe disa të tjera, kandidati për deputet ishte kandidati i propozuar nga zgjedhësit, deputet i pavarur, të këtij karakteri ishin, dhe mendova që t'i qartësonim dhe jua nisa prapë aktin. Prapë është propozim i Komisionerit, mendoj unë, sepse bëri administrata gjithë ato korrigjime teknike, në qoftë se ka në përmbajtje, nuk e kuptoj këtë pjesë të përmbajtjes.

Znj. I.Nano: Zoti Meta, ju lutem, mundet të na referoni ku janë ndryshimet tuaja si administratë, se sigurisht, e theksojmë për të disatën herë, është tagër i Komisionit Rregullator të vendosë mbi përmbajtjen e aktit, në dashtë, ta rrëzojë komplet...

Z. M.Çakaj: E nderuar, të bëj një ndërhyrje të vogël për procedurë? Atëherë, në nenin 5. Të drejtat e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullator, të rregullores së miratuar nga ne të pestë këtu, me votë unanime, parashikohet se: Çdo anëtar dhe kryetari i Komisionit Rregullator, për ushtrimin e funksioneve të veta, ka dhe këto të drejta. Pika 2, gërma "c" parashikon: Të njihet me rendin e ditës së mbledhjes së Rregullatorit dhe me materialet përkatëse, i. jo më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën deri një muaj përpara datës së zgjedhjeve dhe 2.i. jo më vonë se 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën një muaj para datës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve. Pra, të njihet me rendin e ditës, me materialet përkatëse. Materiali përkatës, e nderuar, bien të gjithë dakord, është ky, ky manual, ky projekt, ky propozim, ky është materiali i propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i ditës së shtunë. Tani, minimalisht, ky i sjellë 28 minuta para orarit zyrtar të zhvillimit të mbledhjes nuk ka respektuar rregulloren tonë.

Znj. I.Nano: Atëherë biem dakord me atë që unë propozova më herët për të shtyrë mbledhjen.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Z. M.Çakaj: Jo, absolutisht jo! Ne e kemi një material.

Znj. I.Nano: Jo më vonë se 24 orë.

Z. M.Çakaj: Atëherë hidhe në votim, e shtyjmë apo jo mbledhjen, ne e kemi një material.

Znj. I.Nano: Nuk është çështje votimi.

Z. M.Çakaj: Jo, është tek votimi, referoju rregullores përsëri. Hidhe në votim, nëse shtyjmë mbledhjen apo jo, ose ne e kemi një material dhe nëse këto gabime nuk janë të karakterit thelbësor, por janë të karakterit teknik, absolutisht nuk ka asgjë, i rregullojmë më pas, i gjykojmë, i diskutojmë, i dakordësojmë, i miratojmë ose i rrëzojmë me votë, me atë çfarë na ka caktuar ne ligjvënësi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, gjithë tagrit që na ka përcaktuar, dhe në këtë mënyrë, ne i japim dhe votuesve dhe administratës, pikës fundore të administratës zgjedhore, numëruesve i japim edukimin zgjedhor, trajnimin që kanë nevojë ata, faleminderit!

Znj. I.Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Zonja Vukaj?

Znj. H.Vukaj: Në vijim i mbetem propozimit të zotit Çakaj, pra të vijojmë me aktin që na është informuar dhe përçuar zyrtarisht ditën e shtunë dhe mbi bazën e tij është njoftuar kjo mbledhje dhe meqenëse nuk kemi luksin të shpenzojmë kohë më kot, për shkak se është një material shumë i rëndësishëm, atëherë mund t'i japim shansin administratës, që gjatë leximit të aktit të na vërë, meqenëse nuk janë ndryshime të cilat ndryshojnë apo çënojnë thelbin, të na vërë në dukje që, shiko se është edhe ky gabim drejtshkrimor, ky gabim teknik, ku me *buonsensin* më të madh, secili nga ne mund t'ia marrim për referencë, dhe ta bëjë propozim

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

të tijin. Kjo do të ishte një mënyrë shumë efikase për të ecur akti përpara, faleminderit!

Znj. I.Nano: Zoti Çaka?

Z. D.Çaka: Atëherë, jam dakord me një pjesë të propozimit të kolegëve, që akti ka ardhur vonë dhe mund të jetë e nevojshme për t'u parë edhe nga ana jonë si Komision Rregullator, për të gjitha ato ndryshime që janë bërë, dhe kjo na referon tek rregullorja, që në qoftë se ne kërkojmë kohë, mundet të marrim kohë për ta shqyrtuar aktin. Ndërsa përsa i përket pjesës tjetër, unë besoj se nuk mundet të gjykojmë dot, në këtë moment, kemi një apo dy akte. Ne do kemi atë akt, i cili na është sjellë zyrtarisht nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk mund të themi, jo është i pari dhe të gjykojmë mbi të parin, dhe jo mbi të dytin. Në momentin që kemi një akt të dytë, presupozohet që akti zyrtar, i cili është sjellë, është ky i dyti, aq më tepër që është dhe më i mëvonshmi në kohë dhe besoj që ne, na mbetet e vetmja gjë që në qoftë se duam si Komision Rregullator kohë për të shqyrtuar këtë akt.

Znj. H.Vukaj: Jo, nëse është i pari apo i dyti, i bie që ne duhet ta vlerësojmë me votën tonë.

Znj. I.Nano: Unë iu drejtova dhe më herët sekretarit të Përgjithshëm, aktin e marrë në e-mail. Zoti Merkaj, ndjesë por më duhet ta drejtoj edhe një herë të njejtën pyetje. Akti i dërguar në orën 17, është akt i propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, është akti zyrtar i propozuar nga Komisioneri për t'u shqyrtuar në këtë mbledhje?

Z. Y.Merkaj: Po!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I.Nano: Faleminderit! Atëherë, të nderuar kolegë, jemi para një fakti që...

Znj. H.Vukaj: Por, nuk besoj që e përcakton zoti Merkaj këtë zonja Nano! Nuk e përcakton zoti Merkaj, se cili është akti zyrtar, ndërkohë që kemi ndërtuar gjithë analizën e mendimit mbi bazën e një akti tjetër dhe ndërkohë nga një akt me përmbajtje dhe të pandryshuar deri para gjysmë ore se ne të vinim në mbledhje, na vjen një akt, për të cilin na thuhet anë formale apo anë teknike, në qoftë se është kështu, propozimin tim e dëgjuat. Ato elemente teknike dhe jopërmbajtësor le t'i shpalojmë në moment ose të na sillnin *via e-mail* aktin me një ngjyrë të ndryshme nga ajo e zakonshme, pra e zeza, ku të shikonim ndërhyrjet dhe kjo do ekonomizonte gjithë kohën që po marrim më kot.

Znj. I.Nano: Zoti Meta, ju lutem, mund të prezantoni ndërhyrjet dhe më pas vlerësojmë ne si Komision Rregullator, vijimin e mbledhjes! Pra, jemi para shqyrtimit të aktit, vetëm të vlerësojmë ndërhyrjet tuaja, të administratës le të themi.

Z. E.Meta: Atëherë, të nderuar, ndërhyrjet, më saktë korrigjimet kanë qenë në termat, për shembull, kandidat i pavarur, është zëvendësuar kudo në përmbajtjen e aktit me, kandidatin e propozuar nga zgjedhësit, që ka qenë...do e marrim faqe për faqe?

Znj. I.Nano: Jo, jo aty ku kemi bërë ndërhyrje!

Z. E.Meta: Pra, aty ku është bërë ndërhyrje gjithmonë. Në faqen 6, që ka filluar ndërhyrja, pra kandidati i pavarur është zëvendësuar me kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, dhe kjo është pasqyruar gjithandej, kudo në akt. Në pikën 2. fjala, dhe partive politike dhe koalicion, është bërë, ose koalicioni zgjedhor. Në faqen 7 është referuar neni, baza ligjore, por është përcaktuar Kodi Zgjedhor, pra është

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

shtuar si fjalë, në faqen 7, paragrafi i katërt. Në paragrafin e pestë është saktësuar data prill “04”, pra dita e zgjedhjeve, për shkak të një gabimi, që ishte mars. Është bërë saktësimi për zgjedhjet e datës 25 prill të çdo grup numërimi, duke qenë se dhe vetë manuali është për këto zgjedhje, është bërë saktësimi. Është saktësuar vendimi nr.193 me organin që e ka lëshuar aktin, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në faqen 7. Pra, anëtari i tretë i GNV-së propozohet nga Partia Socialiste, partia politike e shumicës parlamentare, vendimi nr.193, datë 31 mars 2021, është saktësuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si vendim. Në faqen 8 është bërë saktësimi, zëvendësimi i anëtarëve të grupit të numërimit të votave, në rast kur propozohen nga anëtarët e GNV-ve, nga forcat politike që kanë të drejtë të propozohen. Në faqen 9 është bërë saktësimi, regjistrimi filmik, ky regjistrim bëhet vetëm për numërimin e votave të subjektet zgjedhore, duke reflektuar dhe vendimmarrjen tuaj.

Znj. I.Nano: Atë që vendosi Komisioni Rregullator ne mbledhje.

Z. E.Meta: Po! Pra procesin e numërimit të votave të subjekteve zgjedhore, thjesht një *hight light*, le të themi, një theksim. Në gabimet gramatikore, në faqen 10, është hequr një fjalë dhe që ishte dy herë, zgjedhore, për subjektet zgjedhore. Është saktësuar tek modeli KZAZ 30 në faqen 13, te dokumentet e punës të GNV-ve...

Znj. I.Nano: Me titull, materialet zgjedhore dhe dokumenti...

Z. E.Meta: Modeli KZAZ 30 është përcaktuar që, është për deputetët të listave shumëëmërore, në mënyrë që mos të krijoheshin keqperceptime nga anëtarët e GNV-ve për kandidatët, pra se mos ngatërroheshin kandidatët e pavarur, që janë subjektet zgjedhore më vete. Në faqen 14 është po prapë reflektimi i ndryshimit të kandidatëve të pavarur, është saktësuar shtesa të përkatësive të kundërta politike, për grupin e marrë në dorëzim të materialeve zgjedhore. Te model 24

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

është saktësuar procesi që ndodh realisht, dhe është i pasqyruar në procesverbalin model 24, ku është edhe nënshkrimi i punonjësit të policisë, i cili shoqëron fletën e votimit, pra që duhet të jetë i pranishëm. Kudo në akt është model KQV 08 ose modeli i procesverbaleve, është saktësuar me modelin e saktë KQV, nga faqa 23. Në faqen 26 është saktësuar, kushti i pavlefshmërisë së votave, pika b, fletës së votimit i mungojnë një nga vulat, pra është shtuar fjala, një nga vulat. Kudo që janë fjalët “kandidatë” është “kandidatët e listave shumëemërore”, është bërë qartësimi i listave shumëemërore, kudo në tekst, që fillon nga faqa 28 deri në vijuesen. Është bërë saktësimi në faqen 30, ku mungon raporti i mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve i printuar më tej, është përcaktuar në rast procedurash dhe është zhvilluar më tej. Në këtë faqe është bërë saktësimi, vazhdimi i procedurave 2, paragrafi më lartë, vazhdimi i procedurave të verifikimit të materialit të votimit, ishte fjala “dhe” u bë “ose”. Kudo ku është fjala “kuti” në faqen 31, është përcaktuar, në kutinë e materialeve të votimit. Në faqen 32 është bërë saktësimi kur grupi i numërimit të votave është përcaktim. Në rastin kur është përfunduar procesi i verifikimit në kutinë e materialeve të votimit apo në rastin ku në kutinë e votimit janë gjetur procesverbali i mbylljes KQV 08, ku vazhdon procedura e hapjes së kutisë së votimit. Në faqen 35 është bërë thjesht referenca për saktësimin ku ndodhen në këtë të re, pra është bërë një referencë në rast se çënon kushtet e përmendura në pikën 2/a. është bërë përcaktimi në këtë të re. Në faqen 38 është bërë përcaktimi, sqarimi më saktë, që zarfi në fletët e votimit, kur është votuar qartësisht për subjektin zgjedhor, nuk hapen. Janë shtuar dhe tabelat e votave.

Znj . I.Nano: Nga struktura ka ndryshuar akti?

Z. E. Meta: Jo as përmbajtja..

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I. Nano: Atëherë nëse më lejoni unë mendoj se kemi të njëjtën akt, ato ndërhyrje kështu që mund të fillojnë kolegët secili nga ne. Qoftë duke u nisur pararendës i të shtunës apo i të hënës ku kemi ndërhyrje vetëm të referojmë Kreun 1, pika 1 pra që të orientohemi për të bërë diskutimet. Pra nëse do t'i referohemi pikës 1, të vendimit por ne nuk kemi përfunduar shqyrtimin në parim. Nuk kemi votuar në parim. Duhet të votojmë në parim dhe pastaj të kalojmë në përmbajtjen e projektaktit. Propozimi është që mbi aktin që kemi pasur duke pasur parasysh edhe këto ndryshime secili nga anëtarët që ka ose dhe subjektet zgjedhore që kanë propozime për shtesa dhe ndryshime vetëm të referojmë mendoj kreun konkret se ndoshta me faqe ngatërrohemi kreun dhe pikën konkrete.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Z. M. Çakaj: Ekzaktësisht të njëjtin propozim bëri zonja Vukaj përpara se të bënim pushimin. Pra, mbi këtë akt që na ka ardhur zyrtarisht nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ditën e Shtunë nga administrata, bëjmë ato reflektimet, të cilat janë të karakterit teknik, dhe sigurisht bëjmë edhe propozimet tona, shtesa, sugjerime, komente, vërejtje, i hedhim në diskutim; secili ka argumentin e vet; ose e miratojmë ose e rrëzojmë.

Znj. I. Nano: Po pa ditur edhe se çfarë ndryshimesh ishin bërë?! Mund të krijojë një ide që është ndryshuar thelbësisht akti! Prandaj i thashë zotit Meta që 10, 12, 15 ndërhyrje ti dinim dhe të jenë këtu që ne kur propozojmë diçka,

Z. M. Çakaj: Po pra po nuk ishin as dy apo tre, siç na propozoi në fillim sekretari i përgjithshëm, nuk ishin as 10 as 15, por duhet të ishin mbi 25 apo 30. Të paktën aq kishte rreth çerek ore që filloi dhe nuk mbaronte.

Znj. I. Nano: Pas këtij momenti kuptojmë që janë teknike.

Z. M. Çakaj: Megjithatë, duke qenë se rezervojmë të drejtën t'i gjykojmë, nga ana tjetër japim edhe mirëbesimin që drejtori përkatës që bëri relacionin, na sqaroi se janë ndryshime të karakterit teknik,..! Atëherë meqenëse janë ndryshime të karakterit teknik ose gramatik, diskutojmë mbi bazën e këtij akti të sjellë zyrtarisht, dhe gjithë këto ndryshime të karakterit teknik i materializojmë në zbardhjen e aktit, nëse biem ne dakord ta miratojmë.

Znj. I. Nano: Sigurisht! E gjithë ndërhyrja e zotit Meta, ndërprerja e mbledhjes, kishte qëllimin që të kuptonim nga personat që kanë punuar aktin, ku konsistojnë ndërhyrjet. Pasi mbaroi zoti Meta, unë personalisht kuptoj që ndërhyrjet janë të karakterit teknik. Nëse dëshironi kalojmë në votimin në parim të aktit dhe pastaj kalojmë për çdo pikë për çdo kre! Se nuk e kemi votuar! ...

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. H. Vukaj: Cilit akt lind pyetja?

Z. M. Çakaj: Të kujt akt?

Znj. H. Vukaj: A mundet për ekonomi, por edhe për efekt të pak ditëve që na ndajnë, ky akt të përcillet si manual për trajnim; të vazhdojmë me aktin; dhe zoti Meta bashkë me zotin Merkaç duhet të na sugjerojnë gjatë leximit të aktit se ku është ndërhyrja teknike dhe me mirëkuptimin më të madh do ja marrim të mirëqenë ndërhyrjen teknike sepse të gjithë jemi për një akt të konsoliduar dhe një akt që të jetë më i miri! Pse?! Sepse është shumë i rëndësishëm! Kështu që besueshmërinë e marrim gradualisht duke punuar paralelisht me punën e palodhur që kanë bërë ata për t'ju përgjigjur pyetjeve me këto saktësime teknike dhe ndërhyrjeve të tjera. Dhe ndërkohë, punën tonë, e cila normalisht ka marrë dhe kjo kohën e duhur, dhe ka mundin brenda, tek e cila referohet me aktin që ne jemi njohur para disa ditësh! Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Atëherë, ne do të shqyrtojmë atë akt që na ka ardhur zyrtarisht, nuk mund të jemi ne si komision rregullator që përcaktojmë se kush është akti që sjell komisioneri zyrtarisht, është komisioneri që e përcakton; nuk mund të hedhim ne as në votim apo ta ndajmë në këtë akt; nuk është në tagrin tonë, propozimin e ka bërë komisioneri dhe administrata se kush është akti. Në momentin që ne kemi një akt zyrtar do shqyrtojmë aktin zyrtar. Nuk mund të ndajmë ne si komision është ky apo nuk është ky; aq më tepër që pas pyetjes suaj ...

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. H. Vukaj: Atëherë që ta ndajmë këtë, duhet që zoti Komisioner ta tërhiqte atë aktin e parë dhe të na informonte shkresërisht, zyrtarisht që në fuqi është ky akt që po ju dërgoi sot në orën 5 pa tre minuta. Dhe vetëm kjo e ndante se cili ishte vullneti i tij për aktin e parë apo aktin e dytë.

Znj. I. Nano: Asnjë akt nuk është sot në fuqi. Zoti Çaka ndjesë se nuk kishte mbaruar.

Z. D. Çaka: Unë kam një akt të sjellë në këto momente ai është akti që përfundimisht më ka sjellë mua administrata si rregullator. Kam një përgjigje nga administrata që përfaqësohet nga sekretari i përgjithshëm që ky është vullneti i komisionerit. Nuk mund të përcaktojmë ne që kush është vullneti i Komisionerit; unë nuk e di se cila është përgjigja më e saktë. Deri në momentin që unë kam, ...

Znj. H. Vukaj: ... detyrimin për të na bërë me dije zyrtarisht se cili është akti i tij!

Z. D. Çaka: Deri në momentin që unë nuk kam asnjë të dhënë të ndonjë ndryshimi për të përcaktuar se askush përveç nesh po krijohet kjo situatë, ...

Znj. H. Vukaj: Po kjo e dhëna nuk është individuale, zoti Çaka, duhet që ne ti marrim në linjë burokratike gjerat; me radhë pra, ose të tërhiqet i pari ose të tërhiqet i dyti! për shkak se grupet e punës duhet të kenë një akt të konsoliduar dhe me integritet të plotë, unë sot nuk kam kohën e mjaftueshme për të vijuar mbi një akt të cilin nuk e kam marrë në analizë, kështu që nëse mendoni se duhet të vazhdojmë me atë akt, kot që debatoni, e hedhim në votë se cili është akti që do të marrim në konsideratë!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Z. D. Çaka: Edhe një herë, unë mbështeta që fakti që ka ardhur një akt shumë vonë, dhe kohën mund ta kërkojë secili nga ne; unë edhe në seancat e tjera kam kërkuar kohë dhe kam gjetur edhe mbështetjen e tuaj, por nuk mund të hedhim neve në votë të përcaktojmë si është akti i komisionerit. S'është tagri ynë të përcaktojmë këtë gjë. Pra, ti themi ne komisionerit nuk është ky që na ke sjellë por është ky!

Z. M. Çakaj: Mbaruat të lutem! Një sekondë, të lutem! Se tani kjo qenka shumë e çuditshme! Po na lindin dyshime! Ju po thoni që për 28 minuta ju jeni njohur me 30 ndryshime dhe po kërkonit që ne të miratojmë në parim atë akt!

Znj. I. Nano: Një minutë të mbarojë zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: ju po kërkonit që për 28 minuta, atë akt që zyrtarisht na e ka sjellë komisioneri shtetëror i zgjedhjeve, me gjithë këto ndryshime, që në titull ndryshon, ju po thoni ta miratojmë ne tani?!

Z. D Çaka: Jo, jo. Ju mbështes tek kërkesa juaj, ...

Z. M.Çakaj: Ndërkohë, ...

Z.D. Çaka: Jo, qartë thashë se nuk kemi pasur kohë; dhe unë nuk thashë hajde e shtyjmë, ..

Z. M. Çakaj: Unë për vete kam marrë zyrtarisht nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve një akt ditën e shtunë. Është kërkuar të vihet në lëvizje rregullatori ditën e shtunë. Janë bashkëngjitur materiale të cilat kërkohet të miratohen në mbledhje. Unë kam shqyrtuar materialet e paraqitura zyrtarisht nga komisioneri shtetëror i zgjedhjeve, kam nxjerrë gjithë komentet, vërejtjet, shtesat,

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*


sugjerimet, përputhshmëri me kodin zgjedhor, mospërputhshmëri, nuk jam marrë fare me këto gramatikat se është çështje e administratës. Kam disa çështje kryesore të cilat dua ti ndaj me ju kolegë në këtë mbledhje, por unë nuk e marr dot përsipër që për 28 minuta të gjykoj mbi një akt dhe të kem një rendiment të llahtarshëm! Që të miratojmë në mbledhje, ne, këtë akt, që për mendimin tim është akti final, shumë i rëndësishëm, kështu që meqë këto ndryshime janë të karakterit gramatikor apo teknik; jo-përmbajtjesor, siç edhe u përcoll nga drejtori dhe nga sekretari i përgjithshëm. Unë propozoi që aktin që e ka përcjellë zyrtarisht Komisioneri, e miratojmë, ku ka ndryshime i pasqyrojmë i reflektojmë aty; në të kundërt, insistimi juaj më ngre dyshime të arsyeshme edhe mua që ka diçka që nuk shkon këtu!

Z. D. Çaka: Zoti Çakaj po ju them për të disatën herë, mos vini në gojën time fjalë që unë nuk i thashë! Nuk thashë në asnjë moment që hajde shqyrtojmë tani aktin. Ju thashë që nëse kërkojmë kohën, ... dhe me të drejtë ju mbështeta se kur ka ardhur nuk kemi pasur kohë, pra hajde i japim vetes kohë! Nuk thashë në asnjë moment hajde shqyrtojmë aktin. Thashë nuk jemi ne që mund të ndajmë vullnetin e komisionerit! Atëherë, unë kam një kërkesë të shtyhet seanca për tu njohur me aktin!

Z. M. Çakaj: I nderuar koleg, nuk zgjidh gjë shtyrja e seancës, qoftë pak më vonë për sot, qoftë nesër qoftë pasnesër, përveçse i bën dëm procesit të trajnimeve dhe neve si KQZ. Sot në tavolinë kemi dy akte për të miratuar; një akt që është paraqitur zyrtarisht ditën e shtunë nga komisioneri shtetëror i zgjedhjeve, pra ditën e shtunë ka nisur kërkesën, ...

Znj. I. Nano: Ditën e dielë, ...!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Z. M. Çakaj: Dakord, ditën e diele! 24 orëmë parë! Dhe një akt që është paraqitur zyrtarisht 28 minuta para se të fillonte mbledhja.

Znj. I. Nano: Zyrtarisht të dyja!

Z. M. Çakaj: Po, me email zyrtarisht quhet!

Znj. H. Vukaj: Mbledhja është thirrur mbi bazën e aktit të parë!

Z. M. Çakaj: E sqaruam këtu që ndërhyrjet në aktin e dytë i ka bërë kryesisht vetë administrata për pasaktësi gramatikore apo ndërhyrje të karakterit teknik, rreth 30 ndërhyrje, të mos them më shumë!

Tani, meqë këto janë të karakterit teknik, ajo çfarë nuk kuptoj unë, pse qenka kaq shumë problem të diskutojmë këtë aktin që ka ardhur i pari zyrtarisht, sepse në thelb bëhet fjalë për të njëjtin akt, ...?! Apo jo?!

Znj. I. Nano: Unë një pyetje bëra dhe më herët dhe bëhet fjalë për të njëjtin akt me 20, 15 ndërhyrje; është i njëjti akt!

Z. M. Çakaj: Po, atëherë, qenka shumë e thjeshtë për ne të gjithë; diskutojmë këtë akt; reflektojmë ato ndryshime që janë bërë kryesisht nga administrata, dhe nuk ka asnjë lloj paqartësie!

Znj. I. Nano: Unë jam e qartë vetë! Unë prandaj kërkova nga zoti Meta , që të na i paraqiste ndryshimet, ndërhyrjet më mirë të themi, që të kuptoja ku konsistonin këto ndërhyrje. Kolegë?!

Z. M. Çakaj: Më fal e nderuar, jeni dakord ju që këto ndërhyrje janë të karakterit gramatikor ose teknik?!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I. Nano: Me sa dëgjova ...! Ndaj thashë ti shohim një e nga një! Ka kolegë që kërkojnë kohë për ti shqyrtuar!

Z. M. Çakaj: Po pra, po! Por, si logjikë pune dhe si logjikë arsyetimi mund ti shohim një e nga një në aktin e vjetër! Jo në aktin e ri!

Znj. I. Nano: Tani, ose do të flasim për një akt që është zyrtar, ...!

Z. M. Çakaj: Nëse kemi një akt mbi të cilin janë bërë korrigjime ky është akti!

Znj. Iliriana Nano: Do ti kthejmë mbrapsht komisionerit aktin?!

Zoti Muharrem Çakaj: Nuk po i kthejmë mbrapsht Komisionerit asgjë! Kemi akt të ri ne?!

Znj. I. Nano: Ka ardhur një akt në orën 5!


Z. M. Çakaj: I nderuar sekretar i përgjithshëm, a kemi në një akt të ri?!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ju lutem se kemi interesa të ligjshëm politike edhe ne si subjekte politike!

Znj. I. Nano: Zoti Kaziaj, nuk jua dhashë fjalën! Do tua jap fjalën sikundër në çdo mbledhje të rregullatorit dhe uroj të mos keni vërejtje për këtë.

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: Jo, patjetër që unë nuk kam vërejtje. Por ky është një akt shumë i rëndësishëm.

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I. Nano: Atëherë, që të heqim çdo dyshim, po ju japim kohë, një orë, dy orë, pesë orë, ... !!!

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: Jo fillimisht na jepni fjalën se çfarë duhet të themi!

Znj. I. Nano: Patjetër, por nuk mund të ndërprisja fjalën e një anëtari të komisionit rregullator!

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: Anëtari i KRR është person i depolitizuar! Ndërsa unë përfaqësoj një subjekt dhe më duhet të përfaqësoj disa interesa të ligjshëm të këtij subjekti.

Znj. I. Nano: Po, dhe do tu jepet fjala sikundër dhe ju është dhënë çdo herë për çdo akt, për çdo ndërhyrje që keni dashur dhe keni pasur të drejtën tuaj; dhe ju është dhënë nga ana ime.

Atëherë, ende nuk ju kam dhënë fjalën, se isha duke folur vetë, ishte duke folur edhe zoti Çakaj. Zoti Çaka, kërkoi kohë; e kemi të mundur ti japim kohë dhe qoftë sot mbas një ore, mbas dy orësh ti marrim edhe sikundër tha zonja Vukaj, via email, që ne të konsiderojmë më mirë ndryshimet ose ndërhyrjet që ka bërë administrata. Pra, nëse i kemi të dy aktet përpara, edhe aktin e dërguar ditën e diele edhe aktin e dërguar sot, me ndryshimet e nënvizuara, dhe ne mund të gjejkojmë qartësisht ku janë këto ndryshime?! është e mundur kolegë kjo gjë?! Dhe zoti Çaka kur ju kërkoni kohë çfarë keni parasysh?!

Z. D. Çaka: Po, mua personalisht më mjafton edhe një orë kohë për ti parë ndryshimet! Faleminderit!

Znj. I Nano: Zoti Kaziaj, Po?!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: Atëherë unë e respektoj shumë këtë komision siç e dini! Kam qenë pjesëmarrës në 99% të mbledhjeve tuaja, qoftë fizikisht në KQZ, qoftë online, por sinqerisht në 99% të mbledhjeve tuaja, ju vetë nga propozimet e bëra nga komisioneri, pas leximit nën për nën të çdo akti keni bërë ndryshime. Tani është hera e parë që më ndodh që unë të shoh që komisioneri vjen me një akt me afat jo të arsyeshëm. Komisioni Rregullator kërkon kohë për të miratuar atë akt ose ndryshime të atij akti, por që nga administrata thuhet që ka vetëm çështje të karakterit teknik, pse nuk i bën këto rregullatori me aktin e parë në shqyrtimin nën për nën të tij. Ku e ka këtë vështirësi?! Se sinqerisht më lind dyshimi që këtu ka diçka! Në fillim ju zonja kryetare na pyetët: ju, përfaqësuesit e subjekteve politike keni bërë gjë kërkesa për ndryshime për aktin?! Edhe ju anëtarët e rregullatorit nuk kishit bërë ndonjë kërkesë për ndryshim ose ndonjë rishikim të aktit. Tani ne përgatitemi për një akt të cilin e gjejmë në përputhëri me kërkesat e ligjshme të subjekteve që ne përfaqësojmë dhe të ligjit, ndërkohë që për herë të parë konstatoj që ju kërkon kohë për një gjë që ju e keni tagër ta vendosni nëpërmjet miratimit nën për nën. Këto që tha zoti Meta janë shumë minimale si gjëra. Hajde i futemi aktit nën për nën; e miratojmë si të doni ju; me ndryshimet si të vendosë komisioni rregullator, dhe ku është problemi këtu për të kërkuar një orë kohë nga zoti Çaka?! Për çfarë?!

Znj. I. Nano: Zoti Kaziaj, kjo është çështje e zotit Çaka apo e cilitdo anëtar të Komisionit Rregullator!

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: Nuk e vë në dyshim!

Znj. I. Nano: Të lutem, të lutem! Atëherë, ajo që u ngrit me forcë që në fillim të mbledhjes dhe besoj që të gjithë biem dakord, është që akti ka ardhur në orën 17:02 minuta në emaillet tona zyrtare. Dhe, më e pakta, mungesa e kohës është

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

gjeja më e arsyeshme që mund të diskutohet. Në qoftë se bëhet fjalë thjesht për një orë, mua më duket ...!! madje unë e propozova shtyrjen e mbledhjes që në fillim! Dhe tashmë do të kishte kaluar ajo ora e studimit të këtyre ndërhyrjeve të cilat kanë vullnetin e komisionerit, sepse janë dërguar zyrtarisht nga sekretari i përgjithshëm.

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: E nderuar zonja kryetare!

Znj. I. Nano: Dhe pastaj është çështja jone që edhe ato ndërhyrje të mos i shohim të arsyeshme dhe për të cilat anëtari i komisionit rregullator do të shprehet edhe për një fjali edhe për një paragraf si dhe do të propozojë diçka! Kështu që jemi para fakti që një anëtar i komisionit rregullator kërkon një orë kohë nga ky moment për të studiuar ndryshimet, dhe nëse është e mundur, pra, nëse do të arrijmë në konsensus, unë do lutesha për administratën që ndërhyrjet të jenë me një ngjyrë tjetër sikundër zonja Vukaj e theksoj pak më herët. Dhe ne e marrim në shqyrtim pas një ore!

Kolegë! Zoti Nuraj është zonja Vukaj që ka kërkuar fjalën!

Znj. H. Vukaj: Jo më larg se sa mbledhja pararendëse, ku miratuam raportet ose udhëzuesin e raportimit financiar, ne lejuam administratën, me gjithë kuptimin e plotë të fjalës, që të merrte të gatshëm nga ne gabime ortografike, teknike apo korrigjime apo saktësime të tjera të cilat shkonin në sinkron me gjuhën e ligjore. Dhe administrata dhe e pranuan dhe e kemi pranuan dhe më herët këtë lloj praktike. Çfarë të keqe ka edhe publikisht pse duhet të ngremë këtë hije dyshimi, qoftë për ju qoftë për administratën?! Nuk dua ta them por më lind hija e dyshimit, dhe kolegu shumë sjellshëm e tha më lind dyshimi i arsyeshëm, që pranoni të ecim mbi bazën e një akti, për të cilin nuk kemi sigurinë maksimale se çfarë përfaqëson kjo lidhje fjalësh teknike apo gramatikore! Kemi punuar me një akt i cili është i zhveshur nga meraku i të gjithëve. Po e ri-propozoj edhe një

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

herë, siç edhe nja tre herë e bëra, dhe do ishte shumë efikase dhe e dobishme, mendoj unë, por edhe ekonomizmin e kohës e ka brenda që administrata gjatë leximit të aktit të mëparshëm të na sugjerojë propozimet e saj, ose sugjerimet, e saj se propozime është fjalë e madhe dhe nuk e ka për tagër administrata, dhe do t'ia mirëpresim, unë e para do t'ia mirëpres, me qellim që akti të mos pengohet por të shkojë përpara.

Mendoj se është një propozim shumë i thjeshtë dhe pa komplikime dhe heq gjithë hijet e dyshimit. Pse duhet ta komplikojmë ne këtë situatë, veten dhe aktin?! Ndërkohë që ky është një manual dhe do të shpërndahet për trajnim; pra ka urgjencë brenda!

Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Po zoti Nuraj!

Z. L. Nuraj përfaqësues i PD-së:: Një ndërhyrje të vogël, megjithëse pak a shumë jemi në të njëjtën linjë mendimi. Ne kemi punuar ashtu siç u tha e stërtha këtu me një akt që ka ardhur ditën e diele, dhe ne si parti politike e kemi parë dhe nuk kemi bërë sugjerime të mëtejshme pasi kemi rënë dakord me aktin që na është propozuar i pari. Tani administrata, kryesisht ka bërë disa ndryshime, dhe këtu sot na ka sjellë një akt të ri të cilin ne nuk është se e kemi të konsultuar, pavarësisht se pretendohet se akti në vetvete dhe në thelb është i njëjti. E para ne nuk dimë a është në dijeni komisioneri me ndryshimet e bëra, meqenëse këto janë akte që propozohen prej tij. E dyta, pavarësisht se duket pak si për të qeshur po mbledhja ashtu po merr, duke qenë se vete akti ka rëndësinë e vet, do shpërndahet, do të trajnohen dhe ka ndërveprim drejtpërsëdrejti me dritën e zgjedhjeve dhe me numërimin e votave, atëherë ne të na vihet përpara, të ecim me aktin, administrata të shikojë dhe të ndërhyjë dhe aty të reflektohet! Sepse ne s'mund të ecim me një akt të ri, dhe në pikën aq e kaq kemi bërë këto

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

ndryshime dhe hajde ta miratojmë në parim. Nuk dihet edhe nëse ju vete jeni të paqartë dhe ju lindin dyshime të arsyeshme...

Znj. I. Nano: Unë do doja vërtetë që në përfundim të seancës, të gjithë kolegët qoftë edhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore që kanë paraqitur dyshime të arsyeshme, do doja që në mënyrë deklarative ti davarisnin këto dyshime! Faleminderit! Atëherë jemi në kushtet kur një koleg kërkon një orë kohë, do mund t'ia japim një orë kohë!

Z. M. Çakaj: Më fal, e nderuar, po për çfarë e do një orë kohë sepse ju nuk po diskutoni fare për këtë aktin këtu! Dua një orë kohë për aktin! Unë s'jam dakord fare me aktin! Hidhe në votim aktin dhe ose e martojmë ose se miratojmë!

Nga paneli: Cilin akt?!

Z. M. Çakaj: Po këtë aktin që na ka ardhur zyrtarisht!

Znj. I. Nano: Ka një akt me disa ndërhyrje të administratës dhe është në vullnetin e ...

Z. M. Çakaj: Do të zbatohet rregulloren që vete kemi miratuar apo çfarë?!

Znj. I. Nano: 10 minuta pushim, .. jo të qetësohet situata; 10 minuta pushim!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

Rifillon mbledhja

Ora 20:03

Znj. I. Nano: Përshëndetje të nderuar kolegë, të nderuar pjesmarrës. Ndërpremë për pak minuta mbledhjen e Komisionit Rregullator thjesht pasi në kundërshtim me rregulloren pati disa diskutantë njëkohësisht. Atëherë i rikthehemi diskutimeve aty ku i lamë. Sikundër është theksuar dhe më herët kemi një akt të paraqitur për shqyrtim nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ditën e djeshme. Gjithashtu ka ardhur një akt në orën 17:00. Sipas diskutimeve më herët në këtë mbledhje ndryshimet janë bërë me iniciativën e administratës të karakterit kryesisht teknik. Jemi në kushtet kur zoti Çakaj së paku, po diskutonte që të nisim mbi diskutimet mbi aktin e depozituar zyrtarisht dje. Ndërkohë kolegu Çaka kërkoi kohë për të shqyrtuar aktin e ardhur në orën 17:00. Zoti Merkaj i përcollët këtë shqetësim te Komisioneri lidhur me atë se kush është akti zyrtar?

Z. Y. Merkaj: Po zonja Kryetare, i përcolla shqetësimin. Të dyja aktet siç thashë dhe më parë janë të dy aktet të miratuara të konsultuara me Komisionmerin janë sjellë por për shkak të gabimeve teknike që thashë më parë nisur nga akti i dytë. Megjithatë në qoftë se akti i parë është brenda afatit të përcaktuar në rregullore 24 orë përpara shqyrtimit të mbledhjes akti i dytë është... Kështu që dhe Komisioneri tha që nëse do të sillni aktin e dytë merrni kohën e mjaftueshme për të plotësuar afatin 24 orësh për shqyrtimin dhe miratimin e aktit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj. Atëherë kemi dhe një kërkesë të zotit Çaka që kërkoi kohë. Që të mund të jetë në përputhje me rregulloren tonë pra mënyra e paraqitjes së aktit është ajo që e diskutuam dhe më herët pra brenda 24 orëve. Sigurisht që për shkak se ky akt do të shërbej për trajnimin e KZAZ-ve



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

dhe Grupeve të Numërimit të Votave dhe KZAZ-ve për numërimin e votave. Është akt mjaft i rëndësishëm dhe është urgjent për t'u miratuar. Shtroj para jush kolegë mundësinë që të shqyrtoni ose të vlerësoni mundësinë e shtyrjes së mbledhjes në një afat të arsyeshëm për të shqyrtuar aktin që ka ardhur zyrtarisht në orën 17:00. Zoti Çaka mendoj se është e mjaftueshme një orë, nëse kolegët mendojnë që një orë është jo e mjaftueshme. Gjithsesi KQZ-ja, është në kushtet që punon gati në mënyrë të pandërprerë. Të nderuar kolegë edhe një herë ju duket e mjaftueshme një orë apo kemi nevojë për më tepër për të shqyrtuar ose për të vlerësuar me aktin që zyrtarisht ka ardhur në orën 17:00.

Z. M. Çakaj: Edhe përpara pushimit e nderuar zonja Kryetare, ne po diskutonim. Pra, nuk është çështje një orë apo dy orë apo 12 orë, çështja është kë do shqyrtojmë, do të shqyrtojmë aktin që na ka ardhur zyrtarisht ditën e djeshme apo aktin që na ka ardhur zyrtarisht vetëm 28 minuta para fillimit të mbledhjes. Mesa hulumtuam nga Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve na rezulton që ndryshimet kryesore ishin të karakterit teknik apo gramatikor. Në këto kushte unë e gjej me vend që të diskutojmë mbi aktin, i cili na është paraqitur ditën e djeshme zyrtarisht mbi të cilin kemi bërë të gjithë hulumtimin tonë e kemi shqyrtuar kemi nxjerrë komente vërejtje. Shumica përputhen me ato çfarë kanë ndryshuar administrata çfarë pasaktësi ka gjetur administrata, kështu që në këto kushte për të mos humbur kohë, nisur dhe nga rëndësia e këtij akti unë propozoj që të vazhdojmë diskutimin mbi aktin e paraqitur zyrtarisht nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ditën e djeshme.

Znj. I. Nano: Në fakt unë për këtë arsye iu drejtova dhe një herë zotit Merkaj në pushimin që bëmë me ndërprerje. I kërkova që ai shqetësim që u ngrit këtu lidhur me faktin, i cili është varianti zyrtar t'ia përcillte Komisionerit dhe besoj që ishte e qartë dhe përgjigja e zotit Merkaj që përcolli vlerësimin e Komisionerit. Pra, akti i dërguar në orën 17:00, është dërguar zyrtarisht nga

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Komisioneri. Prandaj të nderuar kolegë, pyetja është që të mos marrim 24 orë kohë, sepse koha vërtet është shumë e çmuar. Pra Komisioneri nëpërmjet zotit Merkaj na thotë që akti i orës 17:00 është dërguar zyrtarisht nga ai dhe këtu nuk ka më....

Z. M. Çakaj: Po ashtu dhe akti i mëparshëm, të dy këtë e kemi shqyrtuar, në ndryshim nga akti i mëparshëm ky i riu ka vetëm disa reflektime aq sa ka, të cilat ne marrim përsipër t'i shqyrtojmë, t'i diskutojmë, t'i miratojmë, t'i dakordësojmë të gjitha së bashku kështu që..

Znj. I. Nano: Nuk ka ardhur në formën e komenteve, ka ardhur në formën e një akti të ripunuar. Kjo është çështja zoti Çakaj. Jemi në kushtet e një akti të ri të dërguar zyrtarisht.

Z. M. Çakaj: Tërhiqet akti i parë?

Znj. H. Vukaj: Atëherë nuk paska vetëm çështje të karakterit teknik as gramatikor në qoftë se ky është akti i ri dhe vetëm në qoftë se Komisioneri tërheq aktin e parë, atëherë shtrohet për diskutim sesa kohë doni të nderuar anëtarë të komisionit për të vlerësuar aktin e dytë. Ndërkohë mesa kuptova nga zoti Merkaj, shpalosi gjithë idenë se të dy aktet janë në funksion dhe kemi mes vetes bonsensin që të zgjedhim të vazhdojmë me njërin dhe të kemi përsëri mirëkuptimin që t'i marrim në konsideratë edhe çfarë ka ndërhyrë administrata, gjithmonë nëse ato nuk prekin thelbin e përmbajtjes çdo rreshti apo çdo konteksti fjalie.

Znj. I. Nano: Atëherë zoti Merkaj, më lejoni t'u drejtoj një kërkesë nëse dhe kolegët janë dakord. Do t'iu lutesha të komunikoni dhe një herë me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve si organi që propozon aktin në këtë rast.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Nuk është një akt i propozuar nga asnjë nga anëtarë të Komisionit Rregullator. Duke qenë se është një akt për të cilin ne do ta shyrtojmë, do ta votojmë, do ta miratojmë, do ta ndryshojmë e të tjera. Atë që zonja Vukaj tha më herët cili konsiderohet akti që vjen për shqyrtim në Komisionin Rregullator, akti i dërguar ditën e djeshme, apo akti i dërguar ditën e sotme? Në varësi të kësaj përgjigje ose fillojmë me shqyrtimin e aktit ose lemë një orë... Të nderuar kolegë nëse e ndërpresim për pak të jemi të pranishëm në sallë nëse komunikimi i zotit Merkaj me Komisionerin nuk do të marrë kohë për këtë çështje, faleminderit. Po zoti Merkaj?

Z. Y. Merkaj: Komisioneri është i zënë me operatorët dhe tha që: Tërhiqem nga propozimi i aktit të parë.

Z. M. Çakaj: Pra nuk ishin gabime apo ndryshime vetëm karakteri teknik?

Z. Y. Merkaj: Këto ishin ndryshime vetëm në karakterin teknik.

Z. M. Çakaj: Pse duhet të tërhiqesh nga...Nuk paskan qenë ndryshime vetëm të karakterit gramatikor apo teknik.

Znj. I. Nano: Atëherë të nderuar kolegë jemi në kushtet që kemi marrë propozimin e një akti në orën 17:00. Sipas rregullores do të duhet ta shyrtojmë brenda 24 orëve do të thotë deri nesër në orën 17:00. Ju lutem propozimet tuaja për orën e shqyrtimit të aktit.

Z. M. Çakaj: E nderuar unë do të doja të dija arsyen sepse sinqerisht nuk më ka lënë shije të mirë kjo historia që ka dy tre ndryshime pastaj dalin 30 ndryshime pastaj janë të karakterit gramatikor gjuhësor teknik dhe më pas tërhiqet ky akt. Kështu që unë propozoj të vijë të na sqarojë vetë Komisioneri besoj se është më

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

e rëndësishme. Ky akt miraton punën për nivelin e fundit të administratës zgjedhore dhe në gjykimin tim është nga më të rëndësishmit, sepse i gjithë procesi i parapërgatitjes për zgjedhje i zhvilluar nga komisionet nga administratorët e komisioneve të qendrës së votimit në ditën e zgjedhjeve sigurisht nën mbikqyrjen e Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor pikën fundore dhe pikën menovrogjike e kanë në procesin e numërimit. Kështu që ky proces kaq i rëndësishëm minimalisht kërkon vëmendjen tonë por besoj dhe vëmendjen e Komisionerit. Kështu që unë do të propozoja të vinte të na sqaronte Komisioneri për arsye se pse e ka tërhequr këtë akt, faleminderit.

Znj. I. Nano: Zoti Merkaj mbetet përsëri detyra juaj në qoftë se Komisioneri, ju thatë se ishte pak më parë i zënë, gjithsesi....

Z. Y. Merkaj: Po merret me operatorët për funksionimin e pajisjes PEI. Kështu që është shumë i zënë.

Znj. I. Nano: Atëherë kolegë si mendoni?

Z. M. Çakaj: Unë personalisht nuk mendoj dot asgjë pa gjetur arsyen se pse tërhiqet ky akt dhe atë do të doja të ma sqaronte propozuesi i ngarkuar nga Kodi Zgjedhor që është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Besoj se Komisioni Rregullator është në të drejtën e vet sipas tagrave që i kanë kërkuar Kodit Zgjedhor të bëjë kërkesa dhe minimalisht të kërkojë arsyet sepse propozohet tërhiqet cilat janë arsyet e vërteta se kjo nuk po del qartë, ose sa i shtojmë dyshimet se pse u propozua, pse u tërhoqën pse ishin karakteri teknik nuk po na dalin karakteri teknik dhe në kushtet ku ky është një akt shumë i rëndësishëm. Kur nuk kemi më kohë do të duhet minimalisht të kemi prezent Komisionerin të sqarojë të gjitha arsyet, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I. Nano: Bie dakord me ju por çështja është që nuk lemë dot një moment të dytë pa ditur Komisioneri kur është i gatshëm, i lirë për të ardhur në mbledhjen e Komisionit Rregullator. Po zonja Vukaj?

Znj. H. Vukaj: Realisht Komisioneri mund të jetë i zënë ashtu siç edhe ne jemi të ngarkuar apo të zënë dhe po harxhojmë kohë duke menduar dhe duke aluduar mbi këtë akt. Ky akt dhe ky propozim nuk është thjesht veç një propozim si gjithë të tjerët mori rëndësi të veçantë edhe për sa u diskutua. Kështu që edhe Komisioneri duhet të ishte prezent që në pjesën e dytë pra pas pushimit duhet të ishte prezent këtu për të na sqaruar se ku konsistojnë dhe kush i ka autorizuar këto ndryshime sepse dëgjuam disa herë dhe nga ju, por njëkohësisht dhe nga zoti Merkaj të thoshte në krye të herës që ndryshimet janë bërë me iniciativën e administratës. Pra nëse autorizimi ka ardhur nga Komisioneri le të vijë të na e heqë këtë hije dyshimi këtu dhe më pas dimë se çfarë mendojmë me fatin e procedurës sonë apo të vetë aktit.

Znj. I. Nano: Mendoni të rrijmë ndërkohë live dhe të presim deri sa Komisioneri të vijë, mendoni ta shtyjmë për një afat të pacaktuar mbledhjen deri sa Komisioneri të jetë i lirë?

Z. M. Çakaj: Po për të fituar kohë mund të diskutojmë çështje jashtë rendit të ditës.

Rifillon mbledhja

Ora 20:32

Znj. I. Nano: Kemi mbetur në pikën e kërkesës së zotit Çaka për të qenë prezent Komisioneri në mbledhje. Do të duhet të rrimë të presim pa një afat të

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

caktuar ose duhet të marrim një feed back nga Komisioneri kur mund të jetë në mbledhjen tonë.

Z.Y. Merkaj: Duke qenë se është shumë i ngarkuar mund të propozoja më mirë një pushim.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj e donte fjalën.

Znj. H. Vukaj: Në vijim të çfarë kërkoi zoti Çaka, dhe për të qenë konstruktiv në marrjen e një përgjigje gjithpërfshirëse. Në fakt në kompetencë të plotë pyetje do të doja që t'i adresoheshin bashkarisht dhe hyjnë në kompetencën e përbashkët të Komisionerit dhe nënkomisioneres të dy të autorizuarve. Pra Komisionerit si titullar i këtij institucioni, i cili është bashkërendues në veprimtarinë e impementimit të çfarë do lloj teknologjie të re për këto zgjedhje. Por, dhe Nënkomisioneres si personi i dytë i autorizuar për t'u marrë me procedurat e prokurimit të këtyre pajisjeve, por njëkohësisht edhe me pjesën e rekrutimit apo trajnimeve që mund të jenë bërë deri tani nga administrata. Në lidhje me çfarë ne kërkuam për Komisionerin për vijimin e mbledhjes në praninë e tij. Personalisht mendoj që mund t'i bëhet me dije Komisionerit dhe le të na thotë nëse është i mundur për të qenë prezent apo do ta shtyjme për mungesë të tij ditën e nesërme kur ai të jetë disponibël dhe të proklamojë ai se cilat janë arsyet e aktit një apo aktit dy.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj...

Z. Y. Merkaj: Ndoshta një pushim do të ishte më mirë pasi do të komunikojmë me Komisionerin.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Znj. I. Nano: Patjetër deri në komunikimin tuaj me Komisionerin, ne po bëjmë një pushim jemi në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'u rimbledhur në momentin e parë që do të na njoftoni, faleminderit.

Rifillon Mbledhja

Ora: 20:55

Znj. I. Nano: Rifillojmë mbledhjen publike pas ndërprerjes, i pranishëm është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zoti Celibashi. Zoti Celibashi, i'u është përcjellë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, shqetësimi i ngritur në mbledhjen e Komisionit Rregullator. Ju lutem, mendimin tuaj që dhe ne të vijojmë me shqyrtimin e aktit, pyetjes cilit akt? Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, zonja Kryetare. Në fakt është i njëjti akt, por janë dy versione të aktit, në kuptimin që versioni i dytë është vlerësuar që të ketë disa përmirësime, korrigjime, të cilat për arsye teknike mungonin në versionin e parë, por duke kuptuar ngushtësinë e kohës për ju, për ta shqyrtuar unë jam e mendimit ta tërheq si akt dhe t'ua riprezantojë duke pasur njëkohësisht edhe kohë në dispozicion për ta vlerësuar përmbajtjen e aktit, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit, po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Unë kisha vetëm një pyetje, atëherë përtej ndryshimeve apo përmirësimeve që ka, apo pretendon të sjellë akti i ri. Ka ndryshime të karakterit thelbësorë apo përmbajtësorë në aktin e ri të propozuar nga ju, ditën e sotme në orën 17:02?

Z. I. Celibashi: Po, ka dhe për këtë arsye po kërkoj që ta tërheq aktin, në vlerësimin tim mund ta shikojmë dhe ashtu por dhe në një vlerësim tjetër mund të shikohen si ndryshime të cilat nuk janë të karakterit përmbajtësor. Gjithësesi

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

sidoqoftë edhe për një ndryshim të vogël, koha që kemi patur në dispozicion ka qenë e tillë që nuk ju ka mundësuar për t'a vlerësuar dhe për t'u njohur me atë si akt. Për këtë arsye po e tërheq dhe po e ripërsëris, po e riprezantoj dhe ndërkohë keni kohën pastaj për ta vlerësuar.

Z. M. Çakaj: Faleminderit, unë do të preferoja që sipas rregullores i bie që s'kemi më shumë se 24 orë për miratimin e këtij akti.

Z. I. Celibashi: Urdhëro, po i tërheq komplet të dy aktet. Ligjërisht është varianti i dytë, sepse është konsideruar që varianti i dytë është një variant që ka disa përmirësime në vlerësimin tim. Meqënëse varianti i dytë ju ka ardhur me vonesë dhe nuk keni pasur kohën në dispozicion, keni pasur më pak se një orë nuk e di?

Z. M. Çakaj: Kemi pasur më pak se 28 minuta kohë.

Z. I. Celibashi: Dakord, po e tërheq si akt edhe po e prezantojmë ose sot, ose nesër, ju ndërkohë gjeni kohën.

Znj. I. Nano: Dakord, faleminderit. Besoj situata është e qartë, ne do të mbetemi në pritje të dërgimit zyrtarisht nga ana e Komisionerit të aktit, të cilit do të shqyrtojmë në mbledhjen e ardhshme publike. Të nderuar kolegë, po zoti Nuraj?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Kisha një kërkesë, meqënëse jemi palë të interesuara në lidhje me aktin, pamë se çfarë ndodhi do të kërkonim nga administrata që kur të na dërgohet akti ne, si parti politike të jetë i bashkëshoqëruar dhe me një relacion dhe ku të jenë të evidentuara ndryshimet

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

që janë bërë në aktin e ri. Për ekonomi kohe dhe për ne dhe ju gjithashtu, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit, atëherë duke qenë se u shqyrtuan dhe çështjet jashtë rendit të ditës, mbledhjen e deklarojmë të mbyllur. Natën e mirë.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



19.04.2021

Ora 20:09

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

1.Illirjana NANO Kryetar

2.Arens ÇELA Anëtar

3.Dritan ÇAKA Anëtar

4.Helga VUKAJ Anëtar

5.Muharrem ÇAKAJ Anëtar

• **Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Meta**

Parti Politike: PD, LSI

Znj. I .Nano: Atëherë sipas rradhës është zoti Kaziaj së pari që ka kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës, pastaj zoti Çakaj, zonja Vukaj dhe zoti Çaka. Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zonja kryetare, unë do doja të ngrija një shqetësim komunikuar sot, përsa i përket zonave Baldushk dhe Kashar. Ka të bëjë me një proces shumë të rëndësishëm, që është ai i afishimit të listave të zgjedhjeve, të zgjedhësve në atë zone. Më është komunikuar dhe më është faktuar nëpërmjet pamjeve fotografike që në çdo QV, do i lutesha sekretarit të përgjithshëm të verifikoj këtë gjë. Unë do ta bëj dhe me shkrim pranë KQZ por shrytëzoj rastin



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

qe t'ju vë në dijeni dhe juve si rregullues të situatave me karakter administrativ dhe normativ. Nuk ndodhen listat e zgjedhësve dhe po bëhet një mish mash i madh për sa i përket pjesës së gjetjes së emërit në qendrën e votimit nga qytetarët.

Znj. I. Nano: Në cilën zonë?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Në zonën e Baldushkut dhe Kasharit. Po të shikoni në një pjesë të këtyre QV janë të afishuara listat e vjetra, janë të grisura. Një pjesë tjetër nuk ka asnjë listë të afishuar dhe ky është një shqetësim shumë i madh, nuk e di në qoftë se është një qëllimshmëri e dikujt ose një mospërmbushje e detyrës së zyrtarit vendor apo qëndror të asaj zone. Po sjellim faktin në kuadrin e një shqetësimi të rëndë për sa i përket pjesës së sinjalizimeve që kemi pasur dhe nga votuesit tanë si një subjekt politik dhe nga përfaqësuesi jonë i KQZ dhe nga komisionerët e qendrës së votimit tonë. Do donim që kjo gjë të veprohej sa më shpejt dhe në këtë kuadër të kontrollohej jo vetëm kjo si zonë po e gjithë veprimtaria e zyrtarëve që kanë të bëjnë me afishimin e listave nëpërmjet publikimit të tyre në një vend të posaçëm, në qendrën e votimit të posaçme, të propozuar nga kryetari i bashkisë dhe saktësuar e miratuar nga komisioneri. Në mënyrë që zgjedhësit të mos kenë asnjë lloj vështirësie në ushtrimin e të drejtës së tyre kushtetuese të votimit, ju faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Kaziaj, zoti Merkaj me siguri shqetësimet e zotit Kazij që u ngritën këtu u mbajtën shënim! Për aq sa i takon KQZ të ndërhyjë në këtë situatë. Zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Z. M. Çakaj: Po faleminderit e nderuar, i rikthehemi përsëri vendimit tonë nr.9 datë 24.12 për Veprimtaritë e Ndaluar, të zhvilluara kryesisht nga organet e Administratës Publike, Administratës Shtetërore. Siç jemi të gjithë në dijeni siç kemi rënë të gjithë dakord nenin 91 dhe 92 i Kodit Zgjedhor në mënyrë të qartë ka parashikuar që të gjithë palët në garën zgjedhore të kenë armë të barabarta. Kjo është materializuar me dakordësin tonë në unanimitet në vendimin nr.9. Më lejoni të citoj vetëm nenin 3, pika 1, nën pika 1.1 se çfarë konsiderojmë Veprimtari të Ndaluar. Përkufizimi që ne të pestë së bashku kemi miratuar në unanimitet është se Veprimtari e Ndaluar për t'u promovuar janë veprimtaritë publike, sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi. Për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuara. Në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshin gërma a, mbështetjen dhe promovimin e projekteve ose të investimeve me interes, apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji të energjitikës, telekomunikacionit, veprave ujore çdo lloji në shërbim dhe interes të publikut. Çfarë ka ndodhur, kemi parë Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë i cili jo më larg se para 2 ditësh ka mbështetur dhe promovuar haptazi në shkelje të nenit 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor edhe në shkelje haptazi të vendimit të Komisionit Rregullator, ka promovuar një projekt në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Kemi parë përsëri Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë i cili haptazi në kundërshtim me Kodin Zgjedhor në kundërshtim dhe me bazën ligjore të sapo cituar, ka mbështetur një projekt, një udhëtim lokal nga Rinasi në Kukës. Këto janë totalisht të ndaluara. Unë e ftoj për të disatën herë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve që të kryej të gjitha veprimet të cilat ja ka ngarkuar Kodi Zgjedhor por edhe ne me aktet e normave e kemi autorizuar atë dhe të filloj



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

urgjentisht hetimin për këto shkelje haptazi dhe të përsëritura. Kjo ishte çështja e parë. Së dyti, në nenin 79 të Kodit Zgjedhor parashikohet afishimi i materialeve propagandistike. Në vendimin tonë të Shkurtit kemi bërë dhe përkufizimin e materialeve propogandistike, sigurisht kanë ardhur disa denoncime por edhe partitë politike por edhe në media sociale kemi parë disa postera, banera të mëdhenjë në qytetet Tepelenë, Gjirokastrë, Durrës. Materiale propagandistike të cilat haptazi janë në kundërshtim edhe me parashikimin e nenit 79 të Kodit Zgjedhor por edhe në parashikim me përkuzimin që kemi miratuar po ne të 5, për materialet propagandistike. Në gjykimin tim por referuar edhe Kodit Zgjedhor përgjegjësinë kryesore në këtë pikë e mban sigurisht edhe partia politike, por përgjegjësinë kryesore e mbajnë të 60 apo 61 kryetarët e bashkive të cilët në kundërshtim edhe me Kodin Zgjedhor edhe me vendimet tona që kemi miratuar, së pari ka lejuar afishimin e këtyre materialeve propagandistike të cilat haptazi nuk janë në disfavor por janë totalisht diskriminuese kundër një apo disa subjekteve zgjedhore të cilat janë regjistruar për të marrë pjesë. Pra, në mënyrë të përsëritur, në mënyrë totalisht të kundra ligjshme po çënohet gara, po çënohet barazia e palëve në një proces zgjedhor. Janë vënë në dijeni të një shkrese që i ka drejtuar Komisioneri Shtetëror një subjekti zgjedhor, në fakt më pëlqeu ajo shkresa ishte goxha mirë, ishte një standart që do ta kishte zili dhe Norvegjia, por këtu sjemi në Norvegji jemi në Shqipëri. Sigurisht aspirojmë për t'u bërë pjesë e BE por kur të bëhemi pjesë e BE do ta ruaj atë si model shkrese. Unë e riftoj Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve t'i drejtohet me një shkresë të re jo vetëm subjektit zgjedhor që ka kryer këtë veprimtari të ndalur por gjithë bashkive të Republikës së Shqipërisë, të cilët po shkelin në mënyrë të njëanëshme në favor të një subjekti zgjedhor po shkelin haptazi Kodin Zgjedhor. Pra, është e disata herë që denoncojmë është e disata herë

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

që ne meqë kemi rastin të marrim dhe fjalën të jemi prezent për publikun, është e disata herë që evidentojmë këtu shkelje të akteve normative apo dispozitave të Kodit Zgjedhor nga subjekte zgjedhore recidiviste. Kjo gjë duhet të marri fund, në këtë pikë unë i ripropozoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që ti drejtohet përveç subjektit zgjedhor edhe bashkive. Sigurisht edhe në kuadër të denoncimit të parë të filloj kryesisht hetimin për shkeljen e Kodit Zgjedhor e akteve normative mbi veprimtarinë e ndalara, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj, besoj zoti Merkaj të dy shqetësimet që adresoj zoti Çakaj i keni mbajtur shënim për t'ja përcjellur Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Faleminderit zonja Nano, në fakt çështja që do të diskutoj nuk mban rendin për shkak të rëndësisë së tyre, por për shkak se eventualisht unë në mbledhjen e kaluar e lashë diskutimin në një pikë për të cilën prisja rezultat, apo prisja reagim burokratik apo shkresorë, ndërkohë reagimi është zero. Në mbledhjen e kaluar kam kërkuar të nderuar dhe sot prisja që kjo sallë të ishte e mbushur plot realisht me individ apo përgjegjës apo drejtues të institucioneve të cilat në mënyrë kriminale momentalisht në thonjëza sepse ne juristët e dimë etalonin e të konsideruarit kriminel para kohe dhe kjo fjalë është në pritje nga strukturat ligj zbatuese siç është SPAK. Pra, prisja që sot të kishim drejtuesin e AKSH, drejtuesin e e-Albania, drejtuesin e Drejtorisë të Përgjithshme të Gjendjes Civile, të cilët duhet të na raportonin dhe duhet të na justifikonin se si mundet që të dhënat e mija personale të dhënat e quazi 1 milion banorëve të kryeqytetit, të qarkullojnë poshtë e përjetë në një sistem totalisht partiak dhe të njëanshëm.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Herën e kaluar rendita të gjithë rrisqet dhe përveç rrisqeve në dukje individuale, rrisqe që lidhen me procesin zgjedhor dhe ndikimin në procesin zgjedhor. Pra minimin e punës tonë. Në fakt jo vetëm që të pranishmit e renditur janë inekzistent pra zyrtarët përgjegjësit janë inekzistent por nuk kemi asnjë feedback, raportim, informim nga prokuroria. Do të thoni ju që Prokuroria duhet të marri një shkresë!? Administrata nuk e ka përcjell këtë shkresë! A thua se jemi jashtë këtij institucioni dhe kjo ra në vesh të shurdhët! Kjo është një problematikë e jashëzakonshme zoti Merkaj dhe këto shkresa duhet të ishin përcjell urgjent që atë ditë. Marr të mirqenë se thirrja ime ka qenë publike dhe drejtuesit e SPAK, Prokurori i Përgjithshëm duhet me sensibilitetin maksimal të ishin përgjigjur kësaj thirrje të një anëtari të një nga strukturat më të rëndësishme të KQZ që është përpjekur të ruaj integritetin e procesit përmes akteve dhe shprehjes së vullnetit në secilën prej dispozitave të atyre akteve. E gjej të keqardhur këtë gjendje zoti Merkaj. Megjithatë si individ më pas do marr profilin që më takon por si individ në rradhë të parë. Në momentin kur degjoj që përndjekësit tim apo patronazhistit tim i cili ka luajtur me të dhënat e mia deri në numërin e banesës time, imagjinoni se sa të rriskuar ndjehemi ne të pa vullnetëshmit. Pra unë që skam lënë koncensusin askund të më përdoret ID dhe të qarkullojnë poshtë e përpjetë këto të dhëna edhe për hir të deklaratave që bëj si anëtar i KQZ të ndjehem e rriskuarkur kur përballë kam aureolën mbrojtëse nga lideri i partisë në pushtet, ndaj patronazhistëve. Pra, në vend që keta patronazhist sot të ishin në një ndjesë publike, të ishin në organet ligj zbatuese duke ju përgjigjur për veprimet që kanë bërë ndaj të dhënave personale të gjithë secilit, sot këta janë marrë në mbrojtje. Më lind automatikisht një thirrje dhe një vokacion i brendshëm, ju lutem, ju lutem struktura ndërkombëtare, të akredituar në shqipëri, zonja Kim Ambasadore e Shteteve të Bashuara të Amerikës, zotërinjë të tjerë,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

shkëlqesitë tuaja që drejtoni strukturat që drejtoni organizatat e akredituara në shqipëri dhe që jeni kontributor në antarësimin tonë në NATO pra në NATO. Pra jam shtetase e një vendi në NATO dhe skam garancinë e mbrojtjes së të dhënave të mia. Ju lutem merrni në mbrojtje të dhënat e çdo shqipëtarit përfshirë edhe të dhënat e mia, ndjehem e kërcënuar edhe për shkak të funksionit. Do ta zgjasja edhe më shumë këtë diskutim por ndërkohë po ja le vendim edhe nje problmatike tjetër të rëndësishme siç është shkelja me të dy këmbët e aktit tonë normues për Veprimtaritë e Ndaluara çka haptazi e ka ndikuar procesin. Më lejoni të përcjell një shqetësim që më vjen nga një zyrtar dhe në kushtet e pabesueshmërisë ndoshta nuk e ka përcjell menjëher pranë institucioneve ligj zbatuese përfshirë këtu edhe institucionin tonë. Ku më proplamon dhe më dokumenton se Kryetarja e Baskisë Durrës, ka miratuar strukturën e re të Bashkisë Durrës me shtesë punonjësish nga viti i kaluar jo më larg se sa Prilli 2021. Ka dy shkelje të rënda në këtë proces më thotë. Së pari e ka miratuar në datën 09 Prill 2021, gjë që është e ndaluar që nga data 25 Dhjetor 2020 dhe Kodi Zgjedhor ju e dini shumë mirë që nuk e lejon. Së dyti, pa miratim nga Këshilli Bashkiak dhe dokumentat i kam të atashuara, i cili siç e dimë ne juristët ka kopetencë miratimin e numërit të punjonjësve të institucionit. Pra, edhe në kundërshtim me ligjin për vetqeverisjen vendore. Së treti, ka miratuar edhe një listë me emra, ku i ka transferuar punonjësit sipas dëshirës më thotë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe me ligjin për nënpunësin civil, ku përcaktohet qartë se, transerohen punonjësit që nuk i ekziton më pozicioni pas rikonstruktimit, si dhe transferimi bëhet nga një komision i posaçëm që vleron vendet e lira për ata që mbeten pa pozicion. Kjo është ajo zoti Merkaj që kam kërkuar përpara dy javësh dhe skam asnjë përgjigje dhe asnjë lloj sensibiliteti nga asnjë prej organeve që duhet të përgjigjeshin për këtë punë. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore. Ku jemi me numërin e punonjësve për cdo muaj në rend progresiv? Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj, zoti Merkaj?

Z. Y. Merkaj: Do tja përcjell Komisionerit edhe këtë shqetësim të zonjës Vukaj! Jemi duke përgatitur edhe shkresat, di që nga Prokuroria e Përgjithshme ka ardhur një përgjigje ose është përgatitur një përgjigje për t'ju drejtuar KQZ, me komunikimin që kam pasur përgjigja vjen nesër. E cila ka të bëjë me të gjitha këto shqetësimet që ka ngritur ose me përgjigjen e shkresës së dërguar nga KQZ për veprimet, veprat penale, që kanë ndodhur deri datën 15 Prill 2021. Shpresoj që të vi nesër dhe ta kemi përpara.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Jashtë rendit të ditës ka kërkuar fjalën dhe zoti Çaka, zoti Çaka!

Z. D. Çaka : Faleminderit zonja Kryetare, një ndër aktet më kryesore dhe të para që Komisioni Rregullator ka miratuar mbas vendimit nr.1 që ishte pikërisht Miratimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator është vendimi nr.2 datë 31.10.2021 Përvojën dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë paisjet e identifikimit biometrik që do të përdoren në zgjedhjet e 25 Prillit. Në vazhden edhe të këtij vendimi janë miratuar edhe akte të tjera nga Komisioni Rregullator si dhe një prej tyre është edhe vendimi për Organizimin e Punës, në Komisionin e Qendrës së Votimit dhe atje kemi normuar që paisjet e identifikimit të elektronikës ato që quhen shkurt PEI të jenë në funksion dhe të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

përdoren nga operatorët teknikë të cilët do të përzgjidhen nga KQZ mbi bazën e aplikimeve që do të bëhen. Për 5199 qendra votimi, minimalisht duhet të ketë nga një operator teknik që do ta përdori këtë paisje dhe duhet të ketë normalisht edhe operatorë rezervë për raste të caktuara evidente. Sepse Komisionet e Qendrave të Votimit, mbi bazën e akteve tona nuk mundet që t'i prekin dhe t'i vendosin në punë këto paisje. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në nenin 14 të tij, se këtë të drejtë mbi të gjitha për trajnimin dhe rekrutimin e këtyre zyrtarëve zgjedhor në lidhje me teknologjinë e informacionit kryesisht me PEI ja kanë kërkuar Nënkomisioneres Shtetërore. Prandaj do të doja që nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm ti përcilleshin nga ana ime nën komisioneres disa pyetje të cilat kanë të bëjnë pikërisht me këto operatorë të cilët do të bëjnë të mundur në zgjedhjet e ditës së Djelë, vënien në punë të paisjes PEI. Pra, pyetja ime e parë është, sa persona kanë aplikuar pranë KQZ për pozicionin e operatorit për t'u mundësuar vënien në punë ditën e zgjedhjeve së paisjes së identifikimit elektronik? Pyetja e dytë, sa prej këtyre personave që kanë aplikuar janë testuar, trajnuar dhe më pas lidhur kontratat e shërbimit? Pyetja e tretë e cila është një pyetje hipotetike, nëse ditën e zgjedhjeve nuk është bërë i mundur mundësimi i lidhjes së kontratave minimalisht me 5199 operatorë për çdo qendër votimi, si është menduar plotësimi i këtyre mungesave? Duhet theksuar që pjesa e operatorëve është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit në ditën e zgjedhjeve dhe të gjithë do të donim absolutisht që ai të shkonte shumë mirë. Por duke pasur parasysh edhe kushtet në të cilat vetë komisioni i zgjedhjeve ka qenë në vështirësi për shkak kë kohës edhe të shkurtër për implementimin e gjithë kësaj teknologjie. Duke pasur parasysh njëkohësisht edhe kohën e shkurtër ditën e zgjedhjeve do të kërkoja që tja përcillnin komisioneres menjëherë dhe sa më shpejt të ishte e mundur të kishim një përgjigje nga ana e



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.04.2021*

Nënkomisioneres sepse jemi shumë pak afër ditës së zgjedhjeve. Do e lija në dorën e saj për ta vlerësuar faktin por sa më shpejt të ishte e mundur do të ishte akoma më mirë, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çaka, atëherë me çështjet që trajtoi zoti Çaka kemi mbyllur trajtimin e çështjeve jashtë rendit të ditës.

